



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 137 Nr. i faq./Br.str/No.pg 01/23
Data/Datum/Date 26/09/2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror

- 1. Miratohet** propozimi Kryetarit të Komunës Nr. 02/2090/23 i datës 08.09.2023 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Ravne shume, zona kadastrale Rahovec, parcela me numër P-71510057-02302-0 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 10000m² (dhjetëmijë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 199774m² (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër metra katror) **I JEPET** në posedim P.SH.E KOSOVES K.K.RAHOVEC SHF.EKO.E PYJ. RAHOVEC, ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-02240-1 në Zonën Kadastrale Rahovec në posedim të P.SH.E KOSOVES K.K.RAHOVEC SHF.EKO.E PYJ. RAHOVEC me sipërfaqe të përgjithshme prej 10000m² (dhjetëmijë metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7577401m² (shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e një metra katror) **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit.
- 2.** Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e institucionit qendror të cekur në pikën **1** të këtij vendimi është për interes publik, përkatësisht për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
- 3. OBLIGOHET**, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës së institucionit qendror të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbjera, si dhe emrin e pronarit të institucionit qendror me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.137/23
Me datë:26.09.2023

